



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2018 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/18), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për kofinansim të projekteve për aktivitete programore të rrjeteve të biznes engjujve

1. Lëndë e thirrjes publike është kofinansimi i aktiviteteve programore të rrjeteve të biznes engjujve në Republikën e Maqedonisë të cilat janë në kahje të promovimit të konceptit të biznes engjujve si instrument alternativ për finansim të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet të kofinansimit të 70 % të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 500.000 denarë veq e veq për secilin rrjet-kërkues dhe atë për realizim të projekteve të cilat përmbajnë:

- Trajnime/ trajnim të sipërmarrësve për takim me biznes engjujt;
- Trajnime/ trajnim, këmbim të përvojave dhe fitimit të aftësive të patjetërsueshme të investitorëve potencial (biznes engjuj) për udhëheqje të procedurës për investim;
- Organizim të takimeve ndërmjet sipërmarrësve dhe biznes engjujve për prezentim të biznes ideve dhe
- Aktivitete promovuese për konceptin për biznes engjujt.

Në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2018 pjesa II, A. Përkrahja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Masa 7. Kofinansim të projekteve për aktivitete programore të rrjeteve të biznes engjujve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/18), janë paraparë mjete në vlerë të përgjithshme prej 1.000.000 denarë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë sipërmarrjet aktive, fondacionet dhe shoqatat qytetare të cilat punojnë si rrjete/klube të biznes engjujve në Republikën e Maqedonisë dhe të cilat janë anëtare të Rrjetit Europjan të biznes engjujve (EBAN: The European Trade Association for Business Angels, Seed Funds and Early Stage Market Players) para ditës së shpalljes së thirrjes publike.

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formulari „Kërkesë – KP BA 2018“
- Formulari „Projekt – KP BA 2018“;
- Dëshmi me të cilën vërtetohet anëtarësimi në Rrjetin Europjan të biznes engjujve (faturë e paguar për anëtarësim për 2017 dhe 2018 me qertifikatë nga banka/svift dhe kopje nga lista e anëtarëve të EBAN);
- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror, jo më e vjetër se 3 (tre) muaj;
- Vërtetim nga Drejtoria e të Hyrave Publike për tatime dhe kontribute të paguara, jo më i vjetër se 3 (tre) muaj;
- Deklaratë se me projektin me të cilin aplikon deri më tani nuk ka shfrytëzuar mjete nga Buxheti i R.M. ose nga donatorë të huaj, e vërtetuar në noter; dhe
- Fletpagesë në vlerë prej 50,00 denarë (Qëllimi i pagesës: Pagesë për taksa administrative, Emërtimi dhe selia e pranuesit: Llogaria trezore, Banka e pranuesit: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Llogaria Trezore:10000000063095, Llogaria: 840 ___ (në varësi të komunës) 03161, Kodin e të ardhurave dhe programi: 722313 00).

Dokumentacioni i lartpërmendur dorëzohet në original ose kopje.

Nëse dokumentacioni dorëzohet kopje, besueshmërinë e dokumentacionit, aplikuesi i kërkesës e vërteton me nënshkrim dhe vulë të vetën në secilën faqe të kërkesës.

Formularët „Kërkesë – KP BA 2018“ dhe „Projekt – KP BA 2018“ për paraqitje në thirrjen publike, aplikuesit mund ti marrin në arkivën ose ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë www.economy.gov.mk si dhe në portalin www.konkurentnost.mk

4. Kriteret për vlerësim të projekteve:

1. Projekti – 60 pikë
2. Biografia e punës së personave që do të jenë të angazhuar në realizim të projektit – 10 pikë
3. Projekte të realizuara – 10 pikë
4. Investime të realizara nëpërmjet rrjetit– 20 pikë

Një aplikues mund të aplikojë vetëm me një projekt për këtë thirrje publike.

Shpenzimet për reprezentacion (drekë, koktej), llogaritë për shërbime komunale (rrymë, ujë, nxemje) telefon dhe internet nuk do të jenë lëndë kofinansimi.

Kërkesat për kofinansim të projekteve për aktivitete programore të rrjeteve të biznes engjujve i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministri i Ekonomisë.

Projektet do të notohen në bazë të kriterëve të lartëpërmendura pas të cilave do të lidhen Kontrata për realizim të projektit, me secilin aplikant, projekti i të cilit është aprovuar nga ana e komisionit.

Kërkesat për kofinansim të projekteve me dokumentacion të kompletuar dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë, rr. „Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup, deri më 18.06.2018.

tel: (02) 3093 445; 3093 508 Ministria e Ekonomisë www.economy.gov.mk.